



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republikc of Kosovo**



**Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi**

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRSTRUKTURË DHE BANIM

RAPORTI GJASHTE MUJOR I PUNËS

2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republikc of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçilane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

Referencë:			Sh. z nr. _____		
Për/Za/To:			z. Lutfi Haziri - Kryetar i Komunës		
CC:					
Përmes/Preko/Throgh:					
Nga/Od/From:			z. Naser Korça – Drejtor i DSHPIB-së		
Tema/Subjekat/ Subjekct:			RAPORTI i PUNES – janar – qershor 2016		
Nr. i Zyrës: Br. Kancelarije: Room No:	8	Lokacioni: Lokacija: Extencion:	DSHPIB	Data: Datum: Date:	23.06.2016
Për aktivitet/Za aktivnost/Foraction/					
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/					
Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/					
Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/				X	
Afati/ Rok/Deadline/					

I nderuar z. Kryetar!

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme të cilat i përkasin fushëveprimtarisë së vet - **Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim** konform buxhetit të projektuar-planifikuar, objektiv të vetin ka pasur arritjen e këtyre objektivave:

- Ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Kompletimi dhe harmonizimi i infrastrukturës ligjore-akteve normative nga fushëveprimi i Drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- Realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi;
- Mirëmbajtja e projekteve të realizuara që kanë të bëjnë me shërbimet publike-infrastrukturën;
- Identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimi, ofrimi i zgjidhjeve të mundshme;
- Krijimi i një ambienti më të sigurt dhe më të shëndoshë për qytetarët.

I. Statusi i lëndëve në procedurë Administrative

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim në procedurë administrative ka shqyrtuar një numër të kërkesave dhe atë konform LPA dhe sistemit unik të përcaktuar nga MAPL për administratën komunale brenda afatit ligjor janë trajtuar këto lëndë si në tabelë:

Të miratuara	680
Të refuzuara	0
Të pezulluara	0
Të hedhura poshtë	0
Në proces të shqyrtimit	95
pranuara gjithsej-Zgjidhur	775

1.1 Rregullimi i infrastrukturës Ligjore(rregulloret)

Projekt- propozimi për ndryshimet dhe plotësimet e:

- Plotësim ndryshimi i Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha dhe Komunale për vitin 2016 (pjesa e DSHPIB) është miratuar.
- Rregullorja për menaxhimin e Mbeturinave (është miratuar në KK, pritet vërtetimi i ligjshmërisë nga MAPL-ja).
- Plani i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Gjilanit 2016-2020 - në procedurë të lektorimit të Zyra Ligjore, duhet shpallet Diskutimi Publik. (është miratuar në KK, pritet vërtetimi i ligjshmërisë nga MAPL-ja).

1.2 Transporti rrugor i udhëtarëve - transporti në linjat urbane - periferik

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj duke përfshirë edhe transportin e rregullt të udhëtarëve me taxi dhe me autobus.

Me vendim sipas Ligjit mbi Transportin Rrugor është bërë vazhdimi/vërtetimi i rendit të udhëtimit në linjat urbane-periferike në territorin e komunës së Gjilanit në vitin 2015 për 17 operator nga 28.02.2015 deri 28.02.2018 për tri vite,

II. PROJEKTET (Kompanitë e mirëmbajtëse përshkrim i shkurtër i punimeve me vlera)

2.1 Projekti - Mirëmbajta Dimërore e rrugëve të Komunës së Gjilanit LOT-I 2015/2016 kontraktues ka qenë kompania “ TALI “ Sh.p.k ku kontrata ka filluar nga data 24.12.2015 deri me 21.03.2016 ku gjatë kësaj kohe ka pasur pastrime të rrugëve në qytet dhe fshatra nga largimi i borës, ku njëkosishtë gjatë muajit shkurt ka pasur vërshime gjatë të reshurave atmosferike të shiut dhe është intervenuar në këto fshatra (malësinë e Zhegovcit komplet është bërë e kalueshme ura në fshatin Bresalc te lagja e Kurteshëve që ka qenë tërësisht e dëmtuar, urën e lagjes së kacabashkëve vendosja e gypave për kalim të qytetarëve si dhe disa lokacione të qytetit (në lagjen e Dardanisë , te Tafa Petroll si dhe në gjitha lokacionet ku ka pasur nevojë në bashkëpunim me Drejtorinë për Shpëtim dhe Emergjencë kemi reaguar për evitimin e problemeve nga vërshimet. Kontrata ka qenë me vlerë 129,486.60€ vlera e punëve ka arritur vlerën -88,468.26 €

- 2.2 Projekti “ Sanimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe fshatra, loto II - punimet kanë filluar në gjitha rrugët e qytetit të Gjilanit më datën 19.04.2016 në rrugën “Idriz Seferi” (nga rruga qarkore deri te parku i qytetit), kryesisht gropa të sanuar përjashtimisht te kolegji Gjilani një shtresë e një shiriti. Kemi vazhduar me sanime nëpër rrugët: Hamdi Kurteshi, Jugu-1, Esat Berisha, Lidhja e Prizrenit (deri te tabela përfundimi Gjilanit), Skifter Arifi, Gazmend Zajmi, Lagjën Dardania I dhe II, Lagjën Dheu i Bardhë, Pajazit Ahmeti, 7 Shtatori etj. Shtresa qarkulluese në këto rrugë: Gjon Sereqi, Isa Boletini (hapësira e zjarrfiksave, Qendra për punë sociale dhe parkingu në fillim të rrugës), Beqir Musliu 1,8,10, Muharrem Ibrahimimi (nga udhëkryqi me Beqir Musliu 11-12 e tutje) Dardani I, Ali Huruglica (I.Dheu i Bardhë). Sa i përket fshatrave kemi filluar kryerjen e komplet rrugës prej Pogradjës drejti te qytetit .
- 2.3 Projekti “Pastrimi i rrugëve mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbërua” , kontraktues “Eco-Higjiena” - Gjilan. Punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës është duke u bërë krasitja, mbjellja e trëndafilave, barit, spërkatja dhe larja e rrugëve. Si informatë shtesë nga kompania është kryer spërkatja e drunjve me preparat “Lëngë Bordulez”, janë duke u vendosur shporta të reja për mbeturina, kurse shportat e vjetra janë riparuar dhe janë vendosur në vende ku nuk ka pasur shporta si dhe në disa fshatra njëkosishtë është bërë edhe rregullimi i parkut te argjendarët ,është bërë shpërndarja e shportave 1100 litra dhe 120 litra për riciklim aksion i marrur” Gjilani Riciklon” pjesmarres Komuna,GAC, dhe kompania RICIKLIM, Gjate muajit prill ka pasur disa aktivitete Per shenimin e dites se TOKES me date 22.04.2016 me organizim të Komunës, GIZ, ECOHIGJIENA dhe GAC, jane bere aktivitete te berbashketa, kemi organizuar aksionin e pastrimit të deponive ilegale jan bërë pastrime të disa lokaconeve , afer piashave të deponia dhe te obketi i Sahat Kulla, njëkosishtë është ndihmuar edhe gjatë vërshimeve në teren .
- 2.4 Projektin “Sinjalizimi vertikal – horizontal, numërizimi i objekteve” është në procese të nënshkrimit të kontratës .
- 2.5 Projekti “Sanimi i ndriçimit publik” në fshatrat e komunës së Gjilanit. Kontraktues “Elektring” nga Ferizaj. Është kryer ndriçimi publik në shumicën e fshatrave ,është duke vazhduar mirëmbajtja nga Kontraktori.
- 2.6 2.5 Projektin “Sanimi i ndriçimit publik” në qytetin Gjilanit, është në procese të nënshkrimit të kontratës .
- 2.7 Projekti “ Rregullimi dhe hapja e Rrugët të rendit të tretë, pastrim lumenjve dhe largim të deponive ”- Fitues tenderi është Elbau me operatorin kemi filluar me 28.04.2016 së pari kemi filluarë te palestra e sporteve “Bashkim Selishta” rrafshimi dhe shtrarje me zhavorë parkingun te shkolla e mesme “Marin Barleti”, përshkak të vërshimeve të urës te lagagja e kurteshve në Bresalcë është bër e kalueshme , largimin e deponive ne lagjen Dheu i Bardhe (rruga kryesore “Avdullah Presheva”, rrugicat tek romet, dhe lagjen 7 Korriku njëkosishtë kemi vazhduar me punimet ne fshatin Livoq i Eperm ne pastrimin dhe thellimin e lumit kurse këto ditë jemi duke punuarë ne hapjen dhe rregullimin e rrugës Mireshe i Vogël - Capar me gjatësi rreth 1150 m’ si dhe rrugën ne lagjën e Sular me Gjatësi prej 600m’
- 2.6 Projekti «Ofrimi Shërbimit të varrimit në komunën e Gjilanit», është kompania N.SH.T »Bereqeti » punët janë duke u realizuar sipas kontratës bashkëpunim me bashkësinë Islame .
- 2.7 Në kuadër të projektit "Projekte të Vogla" ku kontraktues është kompania “ EL-Bau” nga Gjilani në kuadër të këtij projekti janë realizuar këto punime rregullimin e kanalizimit fekal në dy lokacione afër lumit “Mirusha”, sanimin e kolektorit kryesor dhe një rrugicë në “Zabel”, kemi rregulluar rrjetin e kanalizimit fekal një rrugicë në “Zabel”, në një rrugicë në rrugën “Xheladin Kurbaliu (edhe ujësjellësi) dhe në një rrugicë në rrugën “Bajram Llovca”. Gjithashtu është rregulluar trotuari dhe një segment I kanalizimit fekal afër shkollës “Rexhep Elmazi”.

2.8 Projektit “ Pastrimi i lumenjëve”, ku kontraktuese është kompania “ Bardhi “ gjatë kësaj periudhe është pastruar lumi në Livoq të Poshtëm (lumi brenda fshatit në gjatësi $L \approx 700\text{m}$) dhe përroit të fshatit Kufcë e Ulët (në gjatësi $L \approx 500\text{m}$).Me realizimin e këtij projekti janë evituar vërshimet në këto dy lokacione.

2.9 Me projektin “Punimi I kanalizimit te shkolla “Selami Hallaqi” dhe qerdhja “Ardhmëria” I cili projekt është bashkëfinancuar **me rotarianët**.

2.10 Me projektit “Rregullimi I rrethrotullimit në fshatin Shillovë”, punimet janë duke u zhvilluar (punëkryes “El – bau”).(hapësirë gjelbruese ulëse)

2.11 Projekti “Bartja e automjeteve me merimangë” - Kontraktues “Auto Buli” Gjilan. Punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës. Pasqyra e pagesave dhe bartja për pesë muaj nga Compania

Muaji	Nr i fat	Batja e automjeteve	Nr.fatu.	Sigurimi i autoparkut	Nr. i veturave	Vendqe ndrim
Janar	01/16	600. €	02/16	1041.6 €	40	
Shkurt	03/16	540.€	04/16	974.40	36	
Mars	05/16	855.€	06/16	1041.6	57	
Prill	07/16	510	08/16	1008	34	
Maj	09/16	750	10/16	1041.6	50	

2.12 Gjendja e autoparkut (tërheqja dhe vendqëndrimi)

	Periudha e tërheqjes	Automjete të tërhequra	Automjete të liruara	Automjete të mbetura
1	Para 2016			
	Jana-Maj 2016	231	217	Aut. i Policisë-5 Aut. i KK-së- 9
	Total Σ	231	217	

Automjetet në autoparkun e Komunës dhe në atë të Policisë së Kosovës kanë mbetur për shkak të proceduarve gjyqësore.

III. Raporti detal i inspektorëve te komunikacionit dhe shërbimeve publike

Nr.	Numri i inspektimeve	Numri i procesverbaleve	Numri i kundërvajtjeve	Numri gjobave mandator te pa paguara	Numri i përjashtimeve nga komunikacioni	Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës	Nr. Kafiterive qe ju është konfiskuar inventari	Numri i tavolinave te , karriqave , çadrave , tavolina tabure të konfiskuara	Numri reklamave të konfiskuara	Numri i kërkesave të pranuara	Numri i kërkesave të shqyrtuara
Totali	568	281	23	13	28	21	14	201	11	23	20

IV. Të hyrat nga Drejtoria e Shërbimeve Publike deri më 10/06/2016

Të hyrat nga regjistrimi I automjeteve	77,540.00€
Të hyrat nga terheqja e automjeteve	7,185.00€
Të hyrat nga infrastruktura rrugore	7,326.50€
Të hyrat nga shfryt.hap. publike	30,767.30€
Të hyrat nga qeraja	26,590.80€
Të hyrat nga gjobat mandatare	700€
Gjithësejtë	150,109.60€

V. Shpenzimet (pagesat e kryera ndaj operatorëve) për vitin 2015/ faturat e kryera ndaj operatorëve gjatë pesë mujorit të vitit 2016

Auto Buli	11,898.50€
Eco Higjiena	107,336.21€
Bereqeti	85,674.00€
Bass Com	98,875.65€
Zuka Commerce	5,831.60€
Tali mirembajtje dimrore	30,000.00€
Elektring	23,211.70€
Tali mirembajtje verore	20,228.78€
Viva Print	39,460.00€
Bardhi (pastrimi I lumenjëve)	9,821.00€
Elbau	41,892.61€
KEDSI – Ndriqimi Publik qytet dhe fshatra	110,477.59€
TOTALI	584,707.645€

VI. Duke u bazuar në planin e punës, gjendjen në teren dhe ankesat e qytetarëve, DSHPIB në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka hartuar detyrat projektuese, inicime për projektet:

1	Trotuari Lladovë - Zhegër (plotësim i projektit)
2	Rruga "Haki Efendia" (një segment, Kanalizim fekal, Atmosferik, rrugë)
3	Trotuari "Abaz Ajeti" - Velekincë (plotësim i projektit)
4	Rruga "Shyt Mareci" (një segment , Kanalizim fekal)
5	Rruga "Mulla Idrizi" (Kanalizim fekal dhe Atmosferik)
6	Rrugica brenda varrezave në fshatin Përlepnicë
7	Hapësira Publike "Gjon Sereqi"
8	Hapësira Publike Prapa soliterit

9	Rruga "Gjinollët" (Kanalizim fekal, Atmosferik, shtrati I lumit)
10	Rruga "15 Qershori" (Kanalizim fekal dhe Atmosferik)
11	Rruga "Malësia" (Kanalizim fekal dhe Atmosferik)
12	Rekonstruimi I rrugëve në lagjen VIII (plotësim I projektit)
13	Ndërtimi i urës në lagjen "Kacabash" (Pograxhë)
14	Ndërtimi i urës në lagjen "Kurtesh" (Bresalc)
15	Rrjeti I kanalizimit fekal Bresalc, lagjet e mbetura jasht projektit
16	Rrugicat “martirët e Gjilanit” dhe “Vehbi Ibrahim”
17	Trotuari Kufcë e Ulët

Ndërsa inicimi i procedurave për shpalljen e tenderit është bërë për projektet:

1	Rruga "Kumanova" (Kanalizim fekal)
2	Rruga "Gjinollët" (Kanalizim fekal, Atmosferik, shtrati I lumit)
3	Urat "Biqak", "Limonët", "Bilallët"
4	Rrugët e rendit të III-të
5	Hapesira e lire “Iliria” Kamnik
6	Hapesira e lire afër furrës “Qoqaj”
7	Hapesira e lire “Reshat Ymeri”
8	Rrjeti I ujësjellësit Muhaxherët e Livoçit të Ulët
9	Rregullimi i trotuareve dhe rrugicave me kubëza betoni
10	Rregullimi i trotuareve dhe rrugicave me kubëza betoni
11	Rregullimi I rrugëve në lagjen Arbëria
12	Rregullimi I rrugëve në lagjen e Zabelit
13	Rregullimi I rrugëve në lagjen Malësia – Nazim Budrika
14	Rregullimi I rrugëve në fshatin Malishevë
15	Rregullimi I rrugëve në fshatin Përlepnice
16	Rregullimi I rrugëve në lokacionin rruga e Prishtinës – Pajazit Ahmeti
17	Rregullimi I rrugës Rexhep Dajkoci
18	Rregullimi I rrugëve në fshatin Bresalc lagja Sylja - Makiqët
19	Hapesira e lire “Sahat Kulla”

VII. PROJEKTET – që janë duke u realizuar bashkëpunim me zyrën e prokurorit

Nr.	Emërtimi i rrugës	Në realizim	E realizuar	Vlera totale
1.	Asfaltimi i rrugës rrugëve në qytet	Në realizim		
2	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Doberqan	Në realizim		
3	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mireshtë të vogël te baraka	Në realizim		
4	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërnice	në realizim	Ka probleme me kompanine	
5	Asfaltimi i rrugës Gjilan Bujanovcë	Në realizim		
6	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bresalcë	Në realizim		
7	Asfaltimi i rrugës “ Mulla Idrizi”	Në realizim	Ka probleme me projekt	
8	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Livoq I Epërm	në realizim	Ka probleme me nje pronare	
9	Rregullimi i kanalizimit rruga e “ Gjinollëve “	Në realizim		
10	Rregullimi i kanalizimit lagjen Arbëria	Në realizim		
11	Rregullimi i kanalizimit fshatin Bresalcë	Në realizim		
12	Rregullimi i trotuarit fshatin Velekincë	në realizim		
13				

VIII Aktivitete tjera të takimeve dhe bashkëpunimeve

5.1 DSHPIB – stafi ka bërë grumbullimin e shënimeve të performances komunale për ofrimin e shërbimeve publike për vitin 2015 dhe i kemi dorëzuar MAPL-së.

5.2 Me KRU “Hidromorava” kemi vazhduar bashkëpunimin për intervenime në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

- 5.3 Stafi ka marë pjesë në punëtorinë e organizuar nga MAPL për rishikimin e Sistemit për menaxhimin e performancës komunale.
- 5.4 Përgatitjen e të dhënave mbi qiranë të pronës komunale për lokale afariste.
- 5.5 Kemi zhvilluar aktivitete për zbatimin e ligjit për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, për formimin e shoqatave të pronarëve lidhur me administrimin e ndërtesave kolektive
- 5.6 Marrja pjesë në komisione të ndryshme komunale për zgjedhjen e lëndëve për banim social të caktuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari
- 5.7 Kemi pregaditur dhe kompletuar tërë dokumentacionin e ndërtesave të banimit të partneritetit publike private për ndërtesat të ish kadastrit dhe përball Drejtorisë së Urbanizmit.

IX . SFIDAT E DREJTORISE PER VITIN 2016

- a. Shqetësuese kanë qenë reshjet e shumta të cilat kanë shkaktuar vërshime disa herë në qytet dhe fshatra. Vërshimet kanë ardhur si pasojë e gjendjes jo të mirë të shtretërve të lumenjve (hudhja e mbeturinave, devijimet, ndërtimet pa kriterë në brigjet e lumenjve), zënja e kanaleve anësore të rrugëve, ujëlëshesave, mungesa e kolektorëve kryesorë të rrjetit të kanalizimit fekal , mungesa e rrjetit të kanalizimit atmosferik etj.
Kemi qenë vazhdimisht në kontakt me DMSH (drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim), KRU “Hidromorava” dhe të gjithë faktorët tjerë relevant në tejkalimin e kësaj gjendje.
- b. Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja vijave ujore dhe infrastrukturës përcjellëse të tyre mbetet prioritet;
- c. Caktimi i lokacionit të ri të varrezave të qytetit, ju ka dërguar kërkesë urgjente (DUMM)
- d. Ndërtimi i kolektorëve të ujërave fekale në qytet dhe fshatra duke përfshi edhe impiantin për trajtim të ujërave të zeza;
- e. Zbatimi i planit të mobilitetit në trafik ;
- f. Numri i madh i taksive me leje e posaçërisht i atyre pa leje;
- g. Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të kafshëve,
- h. Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të drunjëve dhe rërës;
- i. Ndërtimi i autoparkut- për vendosjen e makinave të aksidentuara dhe tjerat që tërhiqen për shkak të parkingut të gabuar, veprave penale
- j. Për realizimin e kërkesave të qytetarëve, ngritjen e shkallës së ofrimit të shërbimeve ndaj tyre si dhe realizimin e gjitha projekteve që ka planifikuar DSHPIB-ja kërkojmë që të ndahet mjete shtesë.

Me respekt,